



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.693/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: Konzorciumi “ATI- KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk”-Gjakovë kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Grupin e OE: Komtel Projeckt Engineering sh.p.k-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi-Shtyllat Multifunksionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate-kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-19-4733-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, “Kuvendi Komunal Gjakovë”, më datë 11.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ATI- KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk”-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi-Shtyllat Multifunksionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate-kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-19-4733-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjakovë.

II.VËRTETOHET, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi-Shtyllat Multifunksionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate-kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-19-4733-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjakovë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “ATI- KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk”-Gjakovë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 03.07.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 13.06.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 14.08.2019.

Operatori ekonomik ankues: “ATI- KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk”-Gjakovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt:14.10.2019 me nr.693/19, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Digjitalizimi-Shtyllat Multifunksionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerat-kontratë dy vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-19-4733-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “Kuvendi Komunal Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin : 7, 56, 59 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.10.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit ,në raportin e dt: 24.10.2019 sqaron si në vijim: Pretendimi 1: Në dokumentin “Sqarime shtese për OE-Digjitalizimi-Shtyllat Multifunksionale-064.pdf” të datës 08.08.2019 në pyetjen nr. 7 pse në Dosjen e Tenderit janë kërkuar kamera nga 3 Mpx deri në 5 Mpx kur dihet që në bazë të specifikave të kërkuara për atë tip të kamerave ekzistojnë kamera nga 1 Mpx deri në 3 Mpx – përgjigja e AK ka qenë që OE mund të ofrojë kamera 3 Mpx, 4 Mpx ose 5 Mpx. Me këtë konsiderojmë që

kanë bërë shkelje pasi paraprakisht është ditur që do të ofrohen kamera me rezolucion 3 Mpx që janë më të dobëta se sa ato që kemi ofruar ne.

Përgjigje nga eksperti teknik për pretendimin:

Konsiderojmë se është pike ankimore e pa bazuar për faktin se një ankese e tillë do të duhej të behej gjatë fazës së njoftimit për kontratë dhe jo vetëm pasi është përzgjedhur OE, njëherit nuk ka kufizim të konkurrencës pasi kërkohen me 3, 4 ose 5 Mpx.

Pretendimi 2: AK është dashtë të jep përgjegjësi për secilën pikë të kontestuar dhe dëshmuar nga ana jonë. Projekti në fjalë: “Digjitalizimi-Shtyllat Multifunksionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate”, është faza e tretë e projektit të filluar në vitin 2016, ku kanë përfunduar 2 fazat e para.

Është shkelur Neni 7 duke ia mundësuar paraprakisht “Konzorciumit Komtel-Panamic ICT” qasje në dokumentet zyrtare të fazave të mëparshme të Projektit të “Digjitalizimi- Shtyllat Multifunksionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate”.

Përgjigje nga eksperti teknik dhe shqyrtues për pretendimin 2:

Duke u bazuar në dosjen e tenderit pretendimi i ngritur nga OE ankues nuk ka asnjë lidhshmëri me fazën tani ku jemi.

Pretendimi 2.1:

Për fazat e mëparshme të implementuara nga OE ATI-KOS është punuar edhe Statika e shtyllave, dhe kjo është dorëzuar në dosjen e fazës së 2 si dokument i kërkuar nga AK për Statikën së shtyllave. Në këtë tender, edhe pse nuk është kërkuar statika e shtyllave, “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT” KA SIGURUAR NË MËNYRË ILEGALE një kopje të këtij dokumenti dhe të njëjtën e ka integruar në ofertën e saj – duke fshirë vetëm emrin e kompanisë ATI-KOS nga dokumenti origjinal i dorëzuar në Komunë në vitin 2017 gjatë fazës së dytë. Me këtë ka vepruar në kundërshtim me ligjet në fuqi në Kosovë dhe ne e cilësojmë përveç kësaj edhe si VJEDHJE E PRONES INTELEKTUALE nga ana e “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT”. Më poshtë majtas është paraqitur Dokumenti i dorëzuar në dosjen e tenderit nga ana e OE “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT” (gjendet në dokumentin e dorëzuar në tender nga ky konzorcium: “7.2 spec teknik vizatimet shtyllat.pdf”) dhe djathtas është paraqitur Dokumenti origjinal nga ana e ATI-KOS shpk i dorëzuar në Komunën e Gjakovës në vitin 2017.

Ne si autor të shtyllave në fazat e mëparshme dhe si Investitor i Statikës së shtyllave – do të kërkojmë llogaridhënie edhe nga “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT” për përdorimin e dokumenteve tona pa lejen tonë. Kjo sanksionohet edhe me ligjet në fuqi në Kosovë edhe si VJEDHJE E PRONES INTELEKTUALE.

Përgjigje eksperti teknik për pretendimin 2.1:

Konsiderojmë se nuk është subjekt i këtij Aktiviteti dhe si e tille nuk mund te trajtohet, pasi ne kuadër te këtij Aktiviteti nuk ishte kërkuar Statika e Shtyllave sipas dosjes se tenderit, me çka edhe ju ne pretendimin e juaj e theksoni se një kërkesë e tille nuk është subjekt i këtij aktiviteti.

Pretendimi 3:

- a. Nuk kanë Referenca të kërkuara për kontrata të ngjashme.
- b. Nuk e plotësojnë kushtin për vlerën financiare të projekteve


Përgjigje nga eksperti teknik për pretendimin 3:

Pas verifikimi të dosjeve të OE-se konstatojmë se te njëjtit plotësojnë këto kritere dhe janë ne përputhje me kërkesën e AK-se.

Pretendimi 4: “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT” në MAF të paraqitur nga kompania Tripplite ka vetëm LOGO dhe nuk ka vulë të kompanisë e cila e ka lëshuar MAF-in. Ndërsa, dokumenti i paraqitur nga “Konzorciumi “ATI-KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk” ka vulën nga kompania përkatëse e cila është përgjegjëse për rajonin tonë. Çfarë është me rëndësi MAF është nënshkruar nga i njëjti person në të dy rastet, por tek MAF i “Komtel-Panamic ICT” për inventarin Tripplite mungon Vula (e paraqitur më poshtë).

Përgjigje nga eksperti teknik për pretendimin 4:

Ne mënyrë te verifikimit te MAF për të dy OE në fjale me datën: 22.10.2019 kam adresuar një shkresë tek TRIPP LITE për verifikim te MAF dhe përgjigja e tyre ishte se te MAF janë te lëshuar nga te njëjtit dhe janë valid, me poshtë e gjeni komunikimin me te njëjtit:



Pretendimi 5: Konzorciumi “Komtel dhe Panamic ICT” – ka dorëzuar FIZIKISHT në Komunë dokumentet origjinale dhe AK i ka pranuar dokumentet – edhe pse nuk janë kërkuar këto dokumente:

- a. Vërtetimin e ATK,
- b. Vërtetimi nga Gjykata,
- c. Vërtetimi për tatim në pronë dhe
- d. Sigurimin e Tenderit

Këto dokumente kërkohen para nënshkrimit të kontratës kur kanë përfunduar të gjitha procedurat. Këtë konsiderojmë Shkelje të AK dhe paragjykim të fituesit. Këto dokumente na kanë prezantuar Zyrtarët e Komunës së Gjakovës gjatë procesit të Qasjes në Dokumente zyrtare.

Përgjigje nga eksperti teknik dhe shqyrtues për pretendimin 5:

Ekspertët teknik dhe shqyrtues sqaron se pretendimet në lidhje me Vërtetimin e ATK-së, Vërtetimin e Gjykatës, Vërtetimi për tatim në pronë dhe Sigurimin e Tenderit, nuk kanë asnjë implikim dhe nuk ndikojnë asgjë në lidhje me këtë fazë të aktivitetit të prokurimit.

Pretendimi 6:

1. Plani i Trajnimeve – është paraqitur nga ne, bashkë me përshkrimin e moduleve – nuk është pranuar me arsyetim se nuk ka përmbajtje.
2. MAF për inventarin Tripplite është ofruar nga distributori i Tripplite dhe është i vulosur – për dallim që MAF i konzorciumit të shpallur fitues ka vetëm Logo e jo edhe vulën e kompanisë. Për të njëjtën kërkesë MAF-i ynë është refuzuar, gjegjësisht nuk është pranuar. Këtë e konsiderojmë shkelje flagrante të AK.
3. Në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar Datasheet për bateritë, por vetëm janë dhënë karakteristikat e baterive – që për çudi janë 100% të njëjta me ato të ofruara nga “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT”. Ne kemi paraqitur dëshmi që do ti plotësojmë kërkesat.
4. Specifikimi, Datasheet për monitorët – nuk është kërkuar në dosje. Në arsyetim të AK thuhet decidivisht që “Avigilon nuk ka këso produkti” – që e konsiderojmë shkelje të ligjit të LPP, pasi që Komisioni Vlerësues nuk ka kompetencë profesionale për ta paragjykuar një kompani botërore për portofolin e produkteve të veta.
5. Për Workstation të ofruar nga ne, që është produkt i integruar i Avigilon – thuhet që është ofruar me Procesor i5 e është kërkuar me Procesor Xeon. Më poshtë po ju japim disa të dhëna që Procesori i5 është procesor i gjeneratës më të re se sa është kërkuar me dokumentacionin e tenderit dhe i plotëson dhe tejkalon kërkesat e tenderit pasi që është procesor më i ri:
6. Video kartela e ofruar nga ne Intel HD Graphics P4700 ka dy dalje, njëra DVI dhe tjetra Display Port. Në Datasheet të Workstation të dorëzuar nga ne është paraqitur edhe fakti që në paketë vjen edhe konvertori: “1 DisplayPort to DVI adapter”.

7. Per WDR dhe për frames per second (fps) – konsiderojmë që nuk janë fakte të rëndësishme në këtë rast, pasi që Kameran e propozuara nga ATI-KOS janë superiore me rezolucion 5 Mpx dhe tejkalojnë me performansë ato të paraqitura nga “Komtel- Panamic ICT”.

Përgjigje ne pretendimin 6:

1. Ekziston ne Dosje një Plan i Trajnimeve
2. Vlejné përgjigja e pretendimit te 4.
3. Ne njoftim për kontrate dhe Dosje te tenderit nuk kërkohet asnjë Datasheet për bateritë
4. Bazuar ne Datasheet nuk figuron se ofrohet Monitor i te njëjtit Brand atëherë konsideroj se AK duke përdorur nenin 72 duhet te kërkoj sqarim se a ekziston një produkt i tille apo jo dhe a ofrohet me te njëjtën zgjidhje
5. Ne lidhje me procesorin bazuar edhe ne krahasimet e bëra ne ëeb mund te konstatoj se Procesori i ofruar përmbush kërkesën e AK-se
6. Konsideroj se kjo çështje nuk përmbush kërkesën e AK-se pasi e njëjta specifikishta ka kërkuar 2x DP Port, OE do te mund te kërkonte sqarime shtese gjate fazës se pyetjeve shtese për këtë çështje dhe jo te ofroj një produkt i cili do te shtohetj përmes Adaptereve, gjë qe konsideroj se nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-se
7. Oferta e OE-se nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-se, kjo pasi AK ka kërkuar kamera me rezolucion 3, 4 apo 5 Mbps dhe me EDR 130 ndërsa oferta e OE është me 83dBI.

Pretendimi 7:

1. Konzorciumi “Komtel dhe Panamic” – nuk ka paraqitur fare PROJEKT TEKNIK se si do ta realizojë projektin.
2. Konzorciumi “Komtel dhe Panamic” – nuk ka paraqitur fare dëshmi se si do realizojë Sistemin e Zerimit Publik – dhe si do te ndërlidhet me atë ekzistues, si është kërkuar në dosjen e tenderit.
3. Konzorciumi “Komtel dhe Panamic” – për sistemin e kamerave ka ofruar Kamera 3 MPx e cila është e pamjaftueshme në këtë projekt, pasi që në dy fazat e para janë instaluar kamera 5 MPx. “Konzorciumi “ATI-KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk” ka ofruar kamera 5 MPx në ofertën e saj të prodhuesit kanadez MOTOROLA AVIGILON siç janë edhe kamerat ekzistuese të fazave 1 dhe 2.
4. Konzorciumi “Komtel dhe Panamic” – nuk ka sjellë asnjë dëshmi si do të ndërlidhë sistemin ekzistues të kamerave, duke propozuar vetëm sistem paralel, ndërsa ATIKOS ka dorëzuar projektin detal teknik se si do të ndërlidhen sistemet.

Përgjigje ne pretendimin 7:

1. NE dosjen e tenderit si ashtu edhe ne Njoftim për kontrate nuk kam hasur ne asnjë pike ku kërkohet te paraqitet projekt teknik për realizim te këtij projekti.
2. NE dosjen e tenderit si ashtu edhe ne Njoftim për kontrate nuk kam hasur ne asnjë pike ku kërkohet dëshmi se si te realizohet sistemi e zërimit publik te këtij projekti.
3. Oferta e OE-se është ne përputhje me kërkesën e AK-se
4. Ne dosjen e tenderit si ashtu edhe ne njoftimin për kontrate nuk kam hasur ne asnjë pike ku kërkohet te vazhdohet projekti i njëjti andaj konsideroj si pretendim te pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues dhe teknik: Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik dhe shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesën e OE ankues ta aprovoj si pjesërisht të bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Operatori Ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 26.10.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.10.2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 11.11.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, Eksperti shqyrtues dhe teknik, ndërsa përfaqësuesit e AK-së nuk janë prezent ne seance, te njëjtit i kemi njoftuar ne mënyrë te rregullt për mbajtjen e kësaj seance, të njëjtit nuk na kanë njoftuar me arsyen e mos prezencës se tyre , u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Stavileci deklaroj: Si përfaqësues i liderit te konsorciumit, çështja e pare është falsifikimi nga OE i rekomanduar qe ka bere një dokument, Dokumenti i Pare është i punuar nga Ati Kos dhe është dorëzuar me herët ne komune” Dokumenti i statikes se shtyllave’ Kjo kompani ka siguruar ne mënyrë klandestine ky dokument nuk ka qenë ne DT. Shihet qe është punuar Investitori është ATIKos dhe ata i kanë fshirë te dhënat dhe kanë prezantuar me te dhënat e veta, edhe pse nuk ka qenë e kërkuar ne DT nuk kanë pas te drejtë te prezantojnë këtë dokument.

Ne kërkojmë ne bazë te kësaj qe i gjithë procesi duhet te anulohet apo pezullohet deri sa te merret vendimi i Gjykatës përkatëse, pasi qe ne kemi njoftuar edhe liderin dhe organet tjera përkatëse.

Për çështjet teknike realisht nuk jemi me mendimin e ekspertit. pajtuar me pikat 6 dhe 7 . Oferta jone ka qenë me e lire pre 20.459.00 euro për te gjitha pikat qe Autoriteti Kontraktues na ka shpallur qe nuk i kemi plotësuar, Eksperti ka gjete vetëm 2 pika pretendimi 6 dhe 7 pika 6 dhe 7.

Tek pika e 6 Oferta jone e ka plotësuar kërkesën dhe pretendojmë qe i plotëson kushtet.

Tek pika 7 një kamere ka shume specifika dhe prej qindra specifikave ka qenë qe te jete VDR 130 ajo ka pasur 83 DB. Oferta jone ne këtë PA ka qenë me rezulocion 5 MPX për deri sa Konsorciumi fitues ka qenë 3 MPX kërkesa ka qenë nga 3-5 mirëpo ne dy fazat e fundit qe janë bërë ne komune ka qenë me 5 MPX. Oferta jone ka qenë superiore ne çdo element. Oferta jone është me e mire dhe me e lire.

Kërkojmë qe ky AP te anulohet deri sa te vendosin organet kompetente.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti shqyrtues z. Muhadri deklaroi: sa i përket çështjes se a ka falsifikime janë kompetente organet tjera, për çështje teknike eksperti teknik mund te sqaron.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Teknik z. Hisenaj deklaroi: Qëndroj prapa raportit te ekspertizës, për faktin ne këtë ankese ka qenë shume pretendime, e një nder ta ka qenë me MAF ne kemi marr konfirmim se MAFi është ne rregull për te 2 OE-te. Ne lidhje me pretendimin 6 përkatësisht piken 6 dhe 7 konsideroj se OE do te duhej gjatë kohës se pyetjeve dhe sqarimeve shtesë te kërkoj sqarime për këto dy pika pasi qe oferta e OE ankues nuk është ne përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Arsyetim për piken nr. 6 është kërkuar te këtë 2 porte për display, ndërsa OE ka ofertuar me një port dhe njëkohësisht ka ofruar një adapter i cili shndërrohet, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar shëndrrues te një porti dhe nëse do te duhet te quhej si devijim i vogël atëherë përgjegjësin është dashur ta merr Autoriteti Kontraktues,

Për piken 7 specifikisht ne DT është kërkuar qe kamera te jete me rezulocion me 3 MPX gjatë pyetjeve dhe sqarimeve shtesë është lejuar qe OE-te mund te ofrojnë me rezolucion 3,4 dhe 5 MPX. Njëra nga ato ka qenë kërkesë EDR ndërsa oferta e OE ankues është me 83 DR , nëse flasim ne aspektin profesional është e vërtet se kamerat 5 MPX janë me te mira mirëpo nuk është ne përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Për pikat tjera janë te sqaruara ne raport.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Stavileci deklaroi: Ne propozojmë për panelin shqyrtues qe ky proces te anulohet sepse ky është një shkelje e rende.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE

ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin numër 1, ku OE ankues pretendon se në dokumentin “Sqarime shtese për OE-Digjitalizimi-Shtyllat Multifunkionale-064.pdf” të datës 08.08.2019 në pyetjen nr. 7 pse në Dosjen e Tenderit janë kërkuar kamera nga 3 Mpx deri në 5 Mpx kur dihet që në bazë të specifikave të kërkuara për atë tip të kamerave ekzistojnë kamera nga 1 Mpx deri në 3 Mpx – përgjigja e AK ka qenë që OE mund të ofrojë kamera 3 Mpx, 4 Mpx ose 5 Mpx, Paneli Shqyrtues në bazë të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik vlerëson se është pike ankimore e pa bazuar për faktin se një ankese e tillë do të duhej të bëhej gjatë fazës së njoftimit për kontratë, dhe jo vetëm pasi është përzgjedhur OE, po ashtu nuk ka kufizim të konkurrencës pasi kërkohen me 3, 4 ose 5 Mpx.

Në lidhje me pretendimin ankimor numër 2, ku OE pretendon se AK është dashtë të jep përgjegjësi për secilën pikë të kontestuar dhe dëshmuar nga ana jonë. Projekti në fjalë: “Digjitalizimi-Shtyllat Multifunkionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate”, është faza e tretë e projektit të filluar në vitin 2016, ku kanë përfunduar 2 fazat e para. Për këtë pretendim OE ankues pretendon se është shkelur Neni 7 duke ia mundësuar paraprakisht “Konzorciumit Komtel-Panamic ICT” qasje në dokumentet zyrtare të fazave të mëparshme të Projektit të “Digjitalizimi- Shtyllat Multifunkionale, Qyteti i Mençur dhe Kamerate”. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik dhe ekspertit shqyrtues konsideron se në bazë të dosjes së tenderit, pretendimi i ngritur nga OE ankues nuk ka asnjë lidhshmëri me fazën për të cilën është duke u zhvilluar ky aktivitet i prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues duke pretenduar se për fazat e mëparshme të implementuara nga OE ATI-KOS është punuar edhe Statika e shtyllave, dhe kjo është dorëzuar në dosjen e fazës së 2 si dokument i kërkuar nga AK për Statikën e shtyllave. Në këtë tender, edhe pse nuk është kërkuar statika e shtyllave, “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT” KA SIGURUAR NË MËNYRË ILEGALE një kopje të këtij dokumenti dhe të njëjtën e ka integruar në ofertën e saj – duke fshirë vetëm emrin e kompanisë ATI-KOS nga dokumenti origjinal i dorëzuar në Komunë në vitin 2017 gjatë fazës së dytë. Për këtë pretendim ankimor, OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me ligjet në fuqi në Kosovë dhe ky OE ankues e cilëson si VJEDHJE E PRONES INTELEKTUALE nga ana e “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT”. Paneli Shqyrtues duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit teknik dhe ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor nuk është subjekt i këtij aktiviteti dhe si e tillë

nuk mund te trajtohet, pasi në kuadër të këtij aktiviteti nuk ishte kërkuar Statika e Shtyllave sipas dosjes së tenderit, me çka edhe vet OE ankues në pretendimimet ankimore e ka theksuar se një kërkesë e tillë nuk është subjekt i këtij aktiviteti.

Pretendim ankimor tjetër i OE ankues është se OE nuk kanë Referenca të kërkuara për kontrata të ngjashme dhe se nuk e plotësojnë kushtin për vlerën financiare të projekteve. Për këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues në bazë të ekspertizës së ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik konsideron se pas verifikimit të dosjeve të OE-së, konstatohet se te njëjtit plotësojnë këto kritere dhe janë në përputhje me kërkesën e AK-së.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, ku ky OE pretendon se “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT” në MAF të paraqitur nga kompania Tripplite ka vetëm LOGO dhe nuk ka vulë të kompanisë e cila e ka lëshuar MAF-in. Ndërsa, dokumenti i paraqitur nga “Konzorciumi “ATI-KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk” ka vulën nga kompania përkatëse e cila është përgjegjëse për rajonin tonë. Më tej, OE ankues shton se është me rëndësi se MAF është nënshkruar nga i njëjti person në të dy rastet, por tek MAF i “Komtel-Panamic ICT” për inventarin Tripplite mungon Vula. Paneli Shqyrtues në bazë të ekspertëve vlerëson se Eksperti me datën: 22.10.2019 kishte adresuar një shkresë tek TRIPP LITE për verifikim të MAF dhe përgjigja e tyre ishte se të dy MAF janë të lëshuar nga të njëjtit dhe janë valid. Po ashtu, eksperti i ka bashkangjitur përgjigjen e TRIPP LITE, ku përgjigja e tyre vërteton se dy MAF-ët janë lëshuar nga të njëjtit.

Pretendim tjetër i OE ankues është se “Konzorciumi “Komtel dhe Panamic ICT” ka dorëzuar fizikisht në Komunë dokumentet origjinale dhe AK i ka pranuar dokumentet, edhe pse nuk janë kërkuar këto dokumente: Vërtetimin e ATK, Vërtetimi nga Gjykata, Vërtetimi për tatim në pronë dhe Sigurimin e Tenderit. Paneli Shqyrtues vlerëson se në bazë të ekspertit shqyrtues se këto dokumente kërkohej para nënshkrimit të kontratës, kur kanë përfunduar të gjitha procedurat. Paneli Shqyrtues në bazë të ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimet në lidhje me Vërtetimin e ATK-së, Vërtetimin e Gjykatës, Vërtetimi për tatim në pronë dhe Sigurimin e Tenderit, nuk kanë asnjë implikim dhe nuk ndikojnë asgjë në lidhje me këtë fazë të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se “Plani i Trajnimeve – është paraqitur nga ne, bashkë me përshkrimin e moduleve – nuk është pranuar me arsyetim se nuk ka përmbajtje” dhe MAF për inventarin Tripplite është ofruar nga distributori i Tripplite dhe është i vulosur – për dallim që MAF i konzorciumit të shpallur fitues ka vetëm Logo e jo edhe vulën e kompanisë. Më tej, OE ankues shton se për të njëjtin

kërkese MAF-i ynë është refuzuar, gjegjësisht nuk është pranuar, ku OE ankues e konsideron si shkelje flagrante të AK. Tutje, OE ankues pretendon se në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar Datasheet për bateritë, por vetëm janë dhënë karakteristikat e baterive – që për çudi janë 100% të njëjta me ato të ofruara nga “Konzorciumi Komtel-Panamic ICT”, po ashtu specifikimi, Datasheet për monitorët nuk është kërkuar në dosje, si dhe OE ankues potencon se në arsyetim të AK thuhet decidivisht që “Avigilon nuk ka këso produkti”. Më tej, OE ankues lidhur me pretendimin e njëjtë shton se për Ëorkstation të ofruar nga ne, që është produkt i integruar i Avigilon – thuhet që është ofruar me Procesor i5 e është kërkuar me Procesor Xeon, pastaj Video kartela e ofruar nga në Intel HD Graphics P4700 ka dy dalje, njëra DVI dhe tjetra Display Port. OE ankues në këtë pikë pretendon duke shtuar se në Datasheet të Workstation të dorëzuar nga ne është paraqitur edhe fakti që në paketë vjen edhe konvertori: “1 DisplayPort to DVI adapter“, si dhe për WDR dhe për frames per second (fps) OE ankues konsideron që nuk janë fakte të rëndësishme në këtë rast, pasi që Kamerate e propozuara nga ATI-KOS janë superiore me rezolucion 5 Mpx dhe tejkalojnë me performansë ato të paraqitura nga “Komtel- Panamic ICT”. Lidhur me të gjitha pikat e cekura që kanë të bëjnë me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik dhe ekspertit shqyrtues sqaron se në Dosje ekziston një Plan i Trajnimeve, në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit nuk kërkohet asnjë Datasheet për bateritë, bazuar ne Datasheet nuk figuron se ofrohet Monitor i te njëjtit Brand dhe se AK duke përdorur nenin 72 duhet të kërkoj sqarim se a ekziston një produkt i tillë apo jo, si dhe a ofrohet me te njëjtën zgjidhje, Më tej, Paneli Shqyrtues konform ekspertëve sqaron se në lidhje me procesorin dhe bazuar edhe ne krahasimet e bëra ne internet, procesori i ofruar përmbush kërkesën e AK-s, andaj se kjo çështje nuk përmbush kërkesën e AK-së pasi e njëjta specifikisht ka kërkuar 2x DP Port, megjithatë OE do të mund të kërkonte sqarime shtesë gjatë fazës së pyetjeve shtesë për këtë çështje dhe jo të ofroj një produkt i cili do të shtohet përmes Adaptereve, gjë që nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-së. Tutje, oferta e OE ankues nuk është ne përputhje me kërkesën e AK-se, kjo pasi AK ka kërkuar kamera me rezolucion 3, 4 apo 5 Mbps dhe me ËDR 130 ndërsa oferta e OE është me 83dBI.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se konzorciumi “Komtel dhe Panamic” nuk ka paraqitur fare PROJEKT TEKNIK se si do ta realizojë projektin, nuk ka paraqitur fare dëshmi se si do realizojë Sistemin e Zërit Publik, dhe si do të ndërlidhet me atë ekzistues, sic është kërkuar në dosjen e tenderit, për sistemin e kamerave ka ofruar Kamera 3 MPx e cila është e pamjaftueshme në këtë projekt pasi që në dy fazat e para janë instaluar kamera 5 MPX, ndërsa “Konzorciumi “ATI-KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk” ka ofruar kamera 5 MPx në ofertën e saj të prodhuesit kanadez MOTOROLA AVIGILON siç janë edhe kamerat ekzistuese të fazave 1 dhe 2, më tej OE ankues shton se konzorciumi

“Komtel dhe Panamic” nuk ka sjellë asnjë dëshmi si do të ndërlihdë sistemin ekzistues të kamerave, duke propozuar vetëm sistem paralel, ndërsa ATIKOS ka dorëzuar projektin detal teknik se si do të ndërlihdën sistemet. Paneli Shqyrtues konform ekspertëve sqaron se në dosjen e tenderit si ashtu edhe ne Njoftim për kontrate, nuk është hasur ne asnjë pike ku kërkohet te paraqitet projekt teknik për realizim të këtij projektit. Më tej, në dosjen e tenderit si ashtu edhe ne Njoftim për kontrate nuk është hasur në asnjë pikë ku kërkohet dëshmi se si të realizohet sistemi e zërimit publik te këtij projekti, oferta e OE-së është në përputhje me kërkesën e AK-së, si dhe në dosjen e tenderit si ashtu edhe ne njoftimin për kontrate nuk është hasur në asnjë pikë ku kërkohet të vazhdohet projekti i njëjtë, andaj Paneli Shqyrtues konform ekspertëve konsideron si pretendim të pa bazuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertit teknik dhe ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë konform nenit 59 LPP-së, si dhe nuk ka gjetur shkelje ligjore të cilat do të ndikonin në atë mënyrë që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - “Kuvendi Komunal Gjakovë”
- 1x1 OE- ATI- KOS-shpk & N.N.P.I. ArcProject shpk”-Gjakovë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi PACARIZI

